



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	13 - 12 3 2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHOC	7443	2023	1/5



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. nr. 02/175/2016

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me A. Nr.02/175/2016 të datës 11.05.2016, së ankuesit grup ankuesish me adresë banimi rruga

nga Komuna e Prishtinës, sipas Aktgjykimit A.A. nr. 1133/2021, të datës 13.12.2022, së Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrativ, kundër organit të punësimit Universitetit i Prishtinës "Hasan Prishtina", në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet, pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr. A. Nr. 02/288/2014,

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës „ Hasan Prishtina “, në Prishtinë që nga data e pranimit të këtij vendimit, të nxjerr akt administrativ më të cilin ankuesve ua njeh ngritjen në pagën bazë, nga data 21.04.2016, konform Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/151 të datës 06.01.2011, dhe Vendimit Nr. 03/177 të datës 14.03.2014.

- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës „Hasan Prishtina“, në për zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- V. Vendimi hynë në fuqi në ditën e ndëshkimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.09.2014, me numër A. Nr. 02/288/2014, ka nxjerr vendim me të cilin i ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e grup ankuesit

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 14.04.2016 A. Nr. 1963/2014 ka nxjerr aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar Vendimin e datës 02.09.2014 me Anr.02/288/2014 duke kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më qëllim të zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore/ Departamenti për Çështje Administrative me datë 10.06.2016, me numër protokoli 2318/2016, ka nxjerr vendim me të cilin i ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 10.06.2016 me numër protokoli 2318/2016, të Këshillit ka hapur padi konflikt Administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 04.12.2018 A. Nr. 1048/16, ka nxjerr aktgjykim me të cilin aktgjykim ka refuzuara kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar, duke lenë në fuqi Vendimin A. Nr. 02/175/2016, të datës 10.06.2016, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Grup ankuesit të pakënaqur me Aktgjykim A. Nr. 1048/16, të datës 04.12.2018, për mes avokatit për mes Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka parashtruar ankesë tek Gjykata e Apelit e Kosovës.

Gjykata e Apelit e Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative, me A.A.Nr. 1133/2021, të datës 13.12.2022, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin aktgjykim ka aprovuar ankesën e paditëseve si të bazuar, duke e ndryshuar aktgjykim e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative A. Nr. 1048/16 i datës 23.09.2021, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.02/288/2014 e datës 01.10.2014, me numër protokolli 1874/2014, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa A. Nr. 02/288/2014 e datës 02.07.2014 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A. A. Nr. 1133/2021, i Gjykatës së Apelit Departamenti për çështje Administrative; Aktgjykim A. Nr. 1048/2016, i datës 23.09.2021, i gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Ankesë e datës 14.12.2021, drejtuar Gjykatës së Apelit Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi A. Nr. 105/2021 i datës 06.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative; Aktvendim A. Nr. 1048/2016, i datës 10.07.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi ARJ- UZVP. Nr. 53/2020, i Gjykatës Supreme të Kosovës; Aktgjykimi A. Nr. 269/2019, i datës 05.06.2020, i Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative; Ankesë e datës 06.05.2019, drejtuar Gjykatës së Apelit Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi i datës 11.07.2014 i Këshillit Drejtues të Universitetit Hasan Prishtina; Vendimi A. Nr. 02/175/2016, i datës 10.06.2016 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A. Nr. 1963/2014 i datës 14.04.2016 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Lista e pagave për 30% të pagave; Lista e personelit Administrativ të Fakultetit Juridik; Akt emërimi i datës 10.09.2012 i Kontrata e punës e datës 01.10.2010, Akt emërimi i datës 06.09.2012 i Kontrata e punës e datës 28.04.2011, e Akt emërimi i datës 10.09.2012 i Kontrata e Punës e datës 01.10.2010, e Akt emërimi i datës 06.09.2012 i Kontrata e Punës e datës 01.10.2010, e Akt emërimi i datës 10.09.2012 i Kontrata e Punës e datës 05.01.2010, e Akt emërimi i datës 08.02.2012 i datës 10.09.2012 i Akt emërimi i datës 10.09.2012 i Kontrata e Punës e datës 01.10.2010, e Akt emërimi i datës 10.09.2012 i Akt emërimi i datës 15.10.2012 i Kontrata e Punës e datës 05.01.2010, e Akt emërimi i datës 06.09.2012 i Kontrata e Punës e datës 26.02.2010, e Akt emërimi i datës 06.09.2012 i Kontrata e Punës e datës 01.10.2010, e Akt emërimi i datës 04.09.2012 i Akt emërimi i datës 06.09.2012 i Kontrata e Punës e datës 21.10.2010, e Akt emërimi i datës 02.09.2012 i Akt emërimi i datës 02.09.2012 i Kontrata e Punës e datës 04.02.2011, e Akt emërimi i datës 10.09.2012 i Kontrata e Punës e datës 16.12.2010, e Akt emërimi i datës 05.12.2011 i Akt emërimi i datës 01.02.2012 i Akt emërimi i datës 06.06.2016 i kërkesë e datës 16.04.2014; drejtuar Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës; Vendimi Nr. 02/151 i datës 06.01.2011 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Opinion Ligjor; Ankesë e datës 30.05.2014, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve në Universitetin Hasan Prishtina; Vendim i datës 11.07.2014, i Këshillit Drejtues.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e grup ankuesish është e bazuar, pjesërisht sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar aktgjykimin e datës 13.12.2022, A.A.Nr.1133/2021, të Gjykatës Themelore së Apelit/Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim ka aprovuar ankesën e paditëseve si të bazuar, duke e ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative A. Nr. 1048/16 i datës 23.09.2021, duk e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Këshilli si organ i paditur.

Ndërlidhur me çështjen juridike administrative, ankesën e grup ankuesve Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin e parë ankimor në të cilin kërkojnë pagesën në mënyrë retroaktive të shtesave në pagë sipas vendimit të datës 04.01.2011 dhe ka konstatuar që grupi i ankuesve më datë 30.05.2014, kanë parashtruar kërkesë tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek, Universitetin Publik të Prishtinës „Hasan Prishtina”, Prishtinë, me kërkesën që në emër të ngritjes së pagës bazë për 30 0/0 për periudhën 01.01.2011 deri në përfundim e procesit, si dhe tu paguhet kompensimin material për ngritje në pagën bazë, konform Vendimit të Qeverisë Nr. 02/151 të datës 06.01.2011, për ngritjen e pagave për nëpunësit civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesit kërkesë/ankesën për kompensim material për periudhat e lartcekura e kanë bërë jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, e që është në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ku është përcaktuar që: "Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punë".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve të cilët pretendojnë se pagesa e tyre në të ardhmen duhet të bëhet në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr.02/151 të datës 06.01.2011 për ngritje të pagës bazë për nëpunësit civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të administrimit të provave të lëndës ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesve që paga e tyre duhet të ngritet në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.02/151 të datës 06.01.2011 dhe për ngritje të pagës bazë për nëpunësit civil, është i qëndrueshëm sepse në bazë të përshtimit të detyrave të punës ankuesit janë nëpunës civilë, dhe me nenin 4 të Vendimit me Nr. 02/1751 të datës 06.01.2011, përcaktohet se: "Ngritjen pagat për të gjithë shërbyesit civil prej 30 0/0 mbi pagën bazë, duke përjashtuar shtesat që aplikohen jashtë pagës bazë".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqë efekti i këtij vendimi është akoma në fuqi, ankuesve u takon ngritja e pagave sipas këtij vendimi, andaj mbi baze të kësaj udhëheqësi me i lartë administrativ i Universitetit Publik "Hasan Prishtina" në Prishtinë, është i obliguar që të nxjerr akt administrativ me të cilin ua njej



të drejtën këtyre nëpunësve civil në ngritje të pagës bazë, duke marrë për bazë Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.02/151 të datës 06.01.2011, për ngritje të pagës bazë për nëpunësit civilë nga 30.05.2014, kanë parashtruar kërkesë tek Këshilli Drejtues, Universitetin Publik të Prishtinës „ Hasan Prishtina”, Prishtinë.

Me nenin 3 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil thuhet se: "Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë".

Kolegji, pasi që ka analizuar këtë çështje juridike, ka administruar faktet juridike, mbi bazën e fakteve juridike, ka konstatuar gjendjen faktike dhe bazën juridike, dhe mbi bazën e kësaj kolegji ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimin duke i njohur të drejtën e ankuesve sa i përket ngritjes së pagës bazë për 30 0/0 për periudhën 01.01.2011 deri në përfundim e procesit, sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 02/151 të datës 06.01.2011, për ngritjen e pagave për nëpunësit civil, prandaj mbi bazën e kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pas pranimit të këtij vendimi organi i punësimit Universiteti i Prishtinës „ Hasan Prishtina”, në Prishtinë, duhet ta zbatoj vendimin e Këshillit të përcaktuar me piken dy të dispozitivit dhe të veproje në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, të nxjerr akt administrativ lidhur me të drejtën e grup ankuesish të aprovuar sipas dispozitivit të këtij Vendimi.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. nr. 02/175/2016*

Rushit KAJTAZI

[Signature]
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet

Avokatit

Gjyqtarit

Udhëheqësit të Personelit në Fakultetin Juridik

Arkivit të KPMSHCK-së

